



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



05/Nr. 1170/2013

Në bazë të Rregullores për Ndarjen e Bursave për Studentë me numër **01/156/2011** të datës **30.12.2011** në Kuvendin e Komunës, Drejtoria Komunale për Arsime Kulturë Rini dhe Sport shpall:

KONKURS PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTËT E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

Kushtet për aplikim:

Të drejtë për të aplikuar për bursë kanë të gjithë studentët të cilët:

- a) janë banorë rezidentë të Komunës së Hanit të Elezit,
- b) janë student të rregullt, por jo me vet financim,
- c) kanë të dhëna të gjitha provimet e vitit paraprak
- d) të mos jenë përsëritës të vitit
- e) e kanë notën mesatare 7,00 e më të tepër
- f) të jetë student i Universitetit Publik të Kosovës
- g) prioritet kanë studentët prej vitit të dytë e më lartë që kanë likuiduar vitin paraprak

Dokumentet e nevojshme për konkurim:

- a) certifikata e provimeve të dhëna së bashku me fotokopjen e indeksit.
- b) deklarata e bashkësisë familjare.
- c) dëshmia se është invalid i luftës, se është fëmijë i dëshmorit, veteranit të luftës, martirit të luftës, se është person me aftësi të kufizuara dhe se është nga familja në skemën sociale.
- d) certifikatën e vendbanimit
- e) diplomat, mirënjohjet, certifikatat për suksesin e arritur në gara-kurse kombëtare dhe ndërkombëtare në lëmin arsimor.

Shuma e bursës për një vit kalendarik është dhjetëmijë euro (10,000€) që do të përfitojnë 20 student për 10 muaj nga 50€ në muaj.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet në qendrën për shërbim të qytetarëve të komunës.

Afati për aplikim është 15 ditë kalendarike

Hani i Elezit
Data: 21.02.2013

